



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës  
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

Nr. 30/19

Datë: 22/07/19

Në mbështetje të nenit 23 par.1 dhe 2, neni 28 paragrafi 1 pika 1.7 pika 1.8 pika 1.10 neni 29 neni 34 neni 35 LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS si dhe Ligji për plotësim ndryshim i tij Nr. 04/L-226; Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në përbërje të: Valon Prestreshi - Kryetar, Ahmet Krasniqi - Zv. Kryetar, Fatime Haziri - Anëtar, Shaqir Morina Anëtar, në mbledhjen e mbajtur me datën **22 KORRIK 2019** jep këtë:

**MENDIM PROFESIONAL**

- I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (**tutje ref. Autoriteti**), rekomandon Komisionin Vlerësues të Ofertave për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme në Komunën e Prishtinës, i caktuar me Vendimin 01-020/04-194122/18, të datës 08.08.2018 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, të **rishikoj** kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin Publik, të datës 15.06.2019, për Dhënien e Pronës së Paluajtshme, në Shfrytëzim Afatshkurtër për Periudhën 15 vjeqare, për qoshqe.
- II. Autoriteti, **konstaton** se çdo kufizim ligjor apo faktik përmes kushteve dhe kriterëve të caktuar për operatorët të cilët janë potencial për tu angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar nuk është e dëshirueshme, në zbatim të politikave të Konkurrencës.
- III. Komisioni i lartëcekur në paragrafin (I) të këtij dispozitivi, duhet të ofroj kushte të barabarta për transaksione të njëjta për operatorët ekonomik, duke i vendosur të njëjtët në gjendje të favorshme konkurruese përmes mekanizmave ligjorë.

---

**ARSYETIM**

---

1. Më datë 21.06.2019, Autoriteti ka pranuar kërkesën/ankesën me Nr.prot.174/19, 21.06.2019, lidhur me kriteret dhe kushtet e përcaktuara dhe të paraqitura në Njoftimin Publik, të përpiluara nga Komisioni i Komunës së Prishtinës, me datën 15.06.2019.
2. Autoriteti për vlerësimin ex post, të Njoftimit Publik (Ankandit), lëshuar nga Komisioni i Komunës së Prishtinës, me datë: 15.06.2019, është vënë në funksion pas ankesës me Nr.prot.174/19, datë:21.06.2019, të shfrytëzuesve aktual të Qoshqeve (kioskave) në komunën e Prishtinës.-
3. Lidhur, me këto kritere kanë reaguar shfrytëzuesit aktual të Qoshqeve, të cilët pretendojnë se me këtë Ankand, i'u është shkelur e drejta e tyre për pjesëmarrje në Ankand, për shkak të kriterëve jo konkurrese dhe favorizuese për bizneset e mëdha.
4. Autoriteti, është në zbatim të Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (abuzimit me pozitën dominuese, marrëveshjeve të ndaluara, praktikave të bashkërenduara dhe realizimit të përqendrimeve të paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga **administrata shtetërore dhe entet rregullatorë** në territorin e Republikës së Kosovës.
5. Legjislacioni i hartuar nga organet e administratës qendrore dhe lokale ose nga iniciues të pavarur, pa u konsultuar me Autoritetin e Konkurrencës, mund të ketë pasojë negative mbi konkurrencën në treg.
6. Zbatimi i hapave kryesor analitikë në vlerësimet legjislative, ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së propozimit, si dhe ndihmon për të shpjeguar nevojshmërinë e një veprimi apo në të kundërt demonstroi që nuk duhet të ndërmerret një veprim i caktuar administrativ.
7. Neni 23 i Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, e parasheh që organet e administratës qendrore dhe lokale, mund të kërkojnë vlerësimin apo mendimin profesional të Autoritetit për çdo ligj, projektligj ose akt-normativ që prek ndjeshëm konkurrencën në treg. Vlerësimi *ex post* i ligjeve, akteve nënligjore, rrjedhimisht vendimeve ekzistuese, është detyrë e Autoritetit dhe presupozon identifikimin e akteve normative në fuqi dhe analizën e pasojave mbi konkurrencën. Bashkëpunimi me rregullatorët sektorialë dhe autoritetet kompetente është i dëshirueshëm dhe në disa raste i domosdoshëm për kryerjen e këtij vlerësimi. Për vlerësimin e projekt-akteve normative, vlerësimi *ex ante*, është e domosdoshme që hartuesit e tyre të bashkëpunojnë dhe të marrin parasysh **sugjerimet dhe rekomandimet** e dhëna nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
8. Një mjedis konkurrues siguron, që do të ketë hyrës potencial në *garë*, për të prodhuar një produkt të ri apo për të ofruar një shërbim më të mirë. Si pasojë,

konkurrenca e fuqishme përbën nxitësin kryesorë të rritjes së produktivitetit dhe siguron, që tregu do të mbetet konkurrues.

*Një mjedis konkurrues i mirëfilltë, jep mundësi të zgjedhjes, shërbime më të mira, cilësi, çmime konkurruese dhe produkte të reja (inovacione).*

9. Aktet normative duhet t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet (operatorët) në treg, trajtimi i ndryshëm duhet të bazohet në kritere objektive.
10. Evitimi i favorizimit dhe krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet e mëdha, mundëson krijimin e ndërmarrjeve që zotërojnë fuqi tregu dhe pengon ndërmarrjet e tjera të jenë konkurruese në treg, e posaçërisht ato ndërmarrje që janë në të njëjtin nivel të operimit dhe ofrimit të shërbimeve.

**Andaj:**

Lidhur me këtë rekomandojmë, Komisionin për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme në Komunën e Prishtinës, si në dispozitiv, shmangien e kufizimeve të konkurrencës në treg (personave fizik dhe juridik) si dhe dhënien e mundësisë të të gjitha ndërmarrjeve duke mos i përjashtuar me kufizime financiare dhe domosdoshmërinë për të poseduar rrjetet e marketeve.

Kërkesa merr epilogun si në dispozitiv të **Mendimit Profesional**.

Me këtë Rekomandim, të njoftohet:

- Komisionin për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme, pranë komunës së Prishtinës
- Paraqitësi i kërkesës/ankesës
- Arhiva

**KOMISIONI  
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS**

  
 Valon Prëstreshi  
 Kryetar

  
 Ahmet Krasniqi  
 Zv. Kryetar

  
 Fatime Haziri  
 Anëtare

  
 Muhamed Krasniqi  
 Anëtar

  
 Shaqir Morina  
 Anëtar